

## **Blerina Rogova Gaxha**

### **Rezyme e Punimit të Doktoratës**

Punimi i doktoratës *Koncepti i vdekjes në letërsinë moderne shqipe: Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli*, ka për objekt trajtimi *vdekjen* në letërsi. Ky është thelbi e koncepti kryesor, që gjeneron diskutimin letrar për *vdekjen* në letërsi, si diskutim për esencat letrare. Titulli shënjon pra objektin e studimit dhe njëkohësisht nënvizon kohën letrare, *modernitetin shqiptar* të fillimit të shekullit XX, me përzgjedhjen e veprave të caktuara të autorëve: *Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli*.

Synimi ynë ishte përpjekja e trajtimit të njëres nga temat më filozofike dhe më të debatueshme në fushën e letërsisë, duke e kërkuar atë në veprën e tre autorëve të letërsisë moderne shqipe, të cilët për nga fuqia e ndjeshmëria letrare dhe ndikimi që kanë pasur janë ndër më të lexuarit e më të interpretuarit. Me vetëdijen se në studimet letrare shqipe topika e *vdekjes* nuk është bërë objekt i veçantë studimi, pretendojmë se kjo shtysë e përligj synimin e studimit. Së këndejmi, kjo është një mënyrë motivimi, siç është dhe intenca për të sjellë rezultate të një pune me interes në fushën e studimeve letrare.

Pikëpyetja themelore që kemi shtruar përgjatë hulumtimit është *koncepti i vdekjes* i autorëve të përzgjedhur, në veprat e tyre reprezentative në poezi dhe në prozë. Nga këtu, motivimi ynë për ta zbuluar marrëdhënien midis shkrimit dhe vdekjes, duke vënë në dukje komunikimin e autorëve me trajtat e vdekjes dhe rolin e atij që *vdes* në këtë *lojë* të shkrimit.

Nisur me Ndre Mjedjen, si autor që në ndarjen periodike të letërsisë ndodhet në kapërcyell nga Romantizmi në Modernizëm, për të kaluar te Lasgush Poradeci, si përfaqësues i poezisë moderne shqipe, te Mitrush Kuteli, si njëri nga prozatorët më të veçantë të letërsisë shqipe, trajtohen *modelet* e krijimit mbi vdekjen, filozofimi poetik për vdekjen dhe komunikimi autorial me trajtat e versionet e vdekjes. Veprat që shqyrtohen janë përzgjedhur si vepra reprezentative në topikën e vdekjes, për ta lexuar e interpretuar konceptin autorial të vdekjes, abstragimin mbi vdekjen, filozofimin mbi vdekjen, vdekjen si temë dhe vdekjen si figurë poetike e prozaike.

Veprat në të cilat kërkohet e hulumtohet prania e reprezentimi i vdekjes, janë: poema *Andrra e jetës*, poezitë *I mbetuni*, *Prendvera*, *Vera*, *Vjeshta*, *Dimni*, të autorit Ndre Mjedja; poezitë *Gjeniu i anijes*, *Lundra dhe flamuri*, *Vdekja e Nositit*, *Përqaqimi*, *Naim Frashërit*, të autorit Lasgush Poradeci; tregimet *Vjeshta e Xheladin Beut*, *Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit* dhe novela *E madhe është gjëma e mëkatit – Tat Tanushi i Bubutimës*, të autorit Mitrush Kuteli.

Me eksplorimin e konotimeve ambiguitive të temës së vdekjes në letërsi dhe ligjësi të fenomenit të vdekjes që i nënshtrohet ligjeve fiksonale dhe komponimit artistik, kemi gjurmuar nëpër artin letrar që thur topikën e vdekjes. Përgjatë kësaj udhe, vdekja në letërsi na është reprezentuar si fundamentale, ngjashëm fundamentale e esenciale siç është jeta. Kësisoj, kërkimi ynë është fokusuar përherë në simbiozën mes jetës e vdekjes dhe anasjelltas, si fenomene opozitare e të pandara, duke i parë në këto margjina shfaqjet e vdekjes e jetës, natyrën, format e trajtat e tyre në kuadër të letërsisë së autorëve tanë, si autorë reprezentativ të modernitetit shqiptar.

Duke e pasur pra për objekt vdekjen në letërsi, e kemi lexuar e interpretuar atë si koncept substancial letrar dhe filozofik, mbështetur përherë në konceptimet autoriale mbi vdekjen si fenomen në tërë sovranitetin e saj.

Në pjesën e parë të punimit, pjesën teorike, kemi renditur mendime e koncepte të ndryshme filozofike e letrare të emrave përfaqësues të dijes filozofike dhe emra të krijimtarisë letrare, për t'u familjarizuar me diskutimet e këndëvështrimet më shenjuese në fushë të filozofisë por edhe të letërsisë mbi vdekjen si fenomen, nocion e temë letrare. Gjithnjë për ta *lexuar* diksursin filozofik e letrar mbi këtë temë, dhe kuptuar se megjithë opinionet e konceptet autentike mendimtarë e letrarë përbashkohen në motivueshmërinë e fenomenit, siç përbashkohen në të vërtetën e pashmangshmërisë së vdekjes si ligj universal njerëzor që gjeneron kuptime dhe ngre pikëpyetje esenciale.

Në vijën e elaborimit të filozofimit mbi vdekjen, ka qenë themelore dhe ka përcjell rrjedhën e studimit mbështetja në konceptet e vdekjes të dijetarëve si: Martin Heidegger, Soren Kierkegaard, Maurice Blanchot, Sokrati, Platoni, Sigmund Freud, Nietzsche etj, siç kanë qenë esenciale studimet e studiuesve shqiptarë për autorët e përzgjedhur, si: Sabri Hamiti, Kujtim M. Shala, Kujtim Rrahmani, Nysret Krasniqi, etj. Një mbështetje të rëndësishme kemi pasur edhe në

kodin biblik, tekstin e Biblës, i cili bëhet referencë e pashmangshme në relacion me tekstet e autorëve dhe konceptimet autoriale mbi vdekjen. Kësisoj, konceptin e vdekjes në teoritë letrare, në filozofi e në Shkrimin Shenjt, e kemi gjetur si një nga konceptet më të motivueshme e më intriguese në këto fusha, mbi të cilat jemi motivuar dhe mbështetur gjatë punës sonë. Krahas mendimeve dhe debateve letrare e filozofike, i jemi referuar edhe diskurseve psikologjike e antropologjike, por në veçanti i jemi referuar diskurseve religjioze mbi fenomenin e vdekjes dhe konceptimin e tij.

Në *pjesën e dytë* dhe themelore të studimit, atë të analizës dhe interpretimit të veprave të autorëve veç veç, Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, kemi synuar evidentimin, analizën dhe interpretimin e poezisë, poemës dhe prozës që *flet* për vdekjen dhe të vdekurit në *lojën* letrare. Konform kësaj, në letërsinë shqipe të modernitetit si letërsi që vë në pah individualitetin e autorit, duke e bërë shenjë të diskursit të vet, koncepti filozofik e letrar i vdekjes dhe reprezentimi i fenomenit bëhet shenjë e ekzistencës apo mosekzistencës autoriale. Prandaj, filozofimi mbi vdekjen, vdekja e krijesave letrare apo vdekja e Subjektit poetik (autorit), shenjon përherë *eidōs*-in autorial të jetës dhe vdekjes.

Brenda kapitujve kushtuar autorëve kemi trajtuar dhe elaboruar praninë e fenomenit të vdekjes si ide, temë, figurë, shenjë, pra si diskurs e filozofim poetik e prozaik mbi vdekjen; kemi elaboruar praninë e vdekjes mimetike, si akt e finalitet fizik, dhe të vdekjes simbolike në gjithë konotimet figurative të kësaj topike, në format e zhanret letrare përkatëse.

Në udhën tonë, të evidentimit të idesë, konceptit dhe temës së vdekjes, të dallimit ndërmjet reprezentimeve të vdekjes nga një vepër në një tjetër, ngjashmërive e ndryshueshmërive, kemi arritur në konkluzione se Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci e Mitrush Kuteli zbulojnë perspektiva të ndryshme, krejtësisht autoriale, të temës së vdekjes në tekstet fikzionale. Në këto divergjenca, sipas leximit që na ka shpjerë kah intenca për ta kuptuar *rrëfimin* e *figurën* - *metoniminë* e *metaforën* e vdekjes, kemi hetuar se në raport me këtë topikë ata konceptojnë, krijojnë dhe promovojnë pluralitet diskursesh, duke nxjerrë në pah temën e vdekjes dhe simbiozën mes jetës e vdekjes, me të cilën shpalosin fuqinë filozofike të tekstit letrar.

Në tekstet referenciale kemi vërejtur se ato na japin disa nga skenat më të ndjeshme e më të prekshme të vdekjes në gjithë letërsinë shqipe – vdekjen e Lokes, vdekjen e Trinës, vdekjen e

Nositit, vdekjen e Gjeniut, vdekjen e Tat Tanushit, të Xheladin Beut e vdekjen e Ago Jakupit. Protagonistë që na japin *konfesionin* e krijueseve të tyre rreth vdekjes, qëndrimin, mendimet, reflektimet, konfrontimin, frymëzimin, pse jo edhe interpretimin e misterit fundamental të ekzistencës sipas mënyrës së Mjedjes, Poradecit e Kutelit. Prandaj, këta autorë në filozofinë e dualitetit të jetës njerëzore *jetë-vdekje*, secili i qaset subjektit të vdekjes sipas mënyrës së tij krejtësisht autentike, për ta *ilustruar* me fjalë, në vargje e në sentenca fenomenin absolut njerëzor në tërë supremacinë e tij dhe për të thurrur nëpërmjet figurimit të vdekjes e filozofimit mbi të, akte e situata të jashtëzakonshme letrare të vdekjes dhe meditime të thella mbi finalitetin dhe eternitetin e qenies njerëzore.

## Doctoral Thesis Resume

The Doctoral dissertation *The Concept of Death in Modern Albanian Literature: Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli*, focuses on the subject of death in literature. This is the essence and the main concept which generates the literary discussion about *death* in literature, as a discussion of what is essential in literature. The title marks the object of this study and simultaneously emphasizes the literary period, i.e. the Modern Albanian Literature of the beginning of the 20th century, with the selection of works by authors: Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli.

The aim of this study is the attempt to address one of the most philosophical and most controversial topics in the field of literature, and to all the three selected authors of Albanian literature who are among the most read and interpreted authors due to their literary power and sensibility. Having in mind that the topic of death never became a particular study object in Albanian literary studies, we claim that this stimulus justifies the purpose of our study. Therefore, this is a way of motivating, as is the intention to bring results of a work of interest in the field of literary studies.

The fundamental question that arises in this research is the concept of death as depicted by the selected authors in their representative works of poetry and prose, as a motivation to discover the relationship between writing and death, as manifested according to the individual traits of writing subjects – i.e. authors, thus emphasizing the communication of authors to the many forms of death and to the role of the one that *dies* in this *game* of writing.

Starting with Ndre Mjedja, as the author who in the periodical division of literature is placed at the end of Romanticism and beginning of Modernism, moving on to Lasgush Poradeci, as a representative of modern Albanian poetry, and then to Mitrush Kuteli, as one of the most prominent prose writers of Albanian literature, this study explores the models of literary creation related to death, the poetic contemplation of death, and the authorial communication with the

forms and shapes of death. The literary works that are the focus of this research have been selected as being representative of works that focus on the theme of death, abstraction of death, philosophizing on death, death as a theme and death as a poetic and prosaic figure. The literary works in which we explore the presence and representation of death are the poems by Ndre Mjedja: *Andrra e jetës, I mbetuni, Prendvera, Vera, Vjeshta, Dimni*; the poems of Lasgush Poradeci: *Gjeniu i anijes, Lundra dhe flamuri, Vdekja e Nositit, Përqaqimi, Naim Frashërit*, and the stories of Mitrush Kuteli: *Vjeshta e Xheladin Beut, Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit dhe E madhe është gjëma e mëkatit – Tat Tanushi i Bubutimës*.

By exploring the ambiguous connotations of the topic of death in literature, and the universal laws that are subject of laws of fiction and artistic compositions, we have traced through the literary art that knitted the topic of death. Throughout this route, death in literature has been represented as fundamental and essential, as is life. Thus, our research has always focused on the symbiosis between life and death, as inseparable phenomena, seeing in these margins the death and life manifestations, their nature, forms and shapes within the literature of the selected authors that are representative of Albanian modernity.

Having death in literature, a literary and philosophic concept, as the object of this dissertation, we have sought along this route different ways of the conception of death, different approaches and philosophical attitudes on the phenomenon as represented by the relevant authors.

In the first part of the paper, which is the theoretical part, we have listed various philosophical and literary concepts on death and dying, retrieved from the eminent philosophers and writers, to familiarize ourselves with the discussions and the most illustrative views in the field of philosophy and literature on death as a phenomenon, notion and literary topic. With the tendency to read the philosophical and literary discourse on the subject, and realize that despite the opinions and authentic concepts, philosophers and writers are cohesive in the motivation of the phenomenon, as they are cohesive in the truth of the inevitability of death as a universal human law that generates meaning and raises essential questions.

In this aspect of the elaboration of the philosophy of death, this study has its basis and has followed the path of the concepts of death of scholars and philosophers such as Martin

Heidegger, Soren Kierkegaard, Maurice Blanchot, Socrates, Plato, Sigmund Freud, Nietzsche; and also, essential were the studies on the work of our authors from Albanian researchers such as Sabri Hamiti, Kujtim Rrahmani, Kujtim M. Shala, Nysret Krasniqi etc. An important reference we have had on the biblical code, the Bible, which becomes an inevitable reference in relation to authors' texts and authorial conceptions of death. Thus, this study has revealed that the concept of death in literary theories, in philosophy as well as the sacred text is one of the most motivational and intriguing concepts in these fields, based on which conclusion we have been motivated and supported for further research.

In addition to literary and philosophical thoughts and debates, we have also referred to psychological and anthropological discourses, but in particular we have referred to religious discourses on the phenomenon of death and its conception.

In the *second* and most fundamental part of the study, which is the separate analysis and interpretation of the works of the authors, Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, we aimed at recording, analyzing and interpreting poetry and prose in texts that address death and dying in the literary *game*. Accordingly, in Modern Albanian literature, as literature that emphasizes author's individuality, making it a sign of its discourse, the philosophical and literary concept of death and the representation of the phenomenon becomes a sign of existence or non-existent authorship. Hence, the philosophy of death, the death of literary creatures, the psychological death, the symbolic death, or the death of the poetic subject (author), always marks the authors *eidos* of life and death.

Within the chapters that discuss the works of the authors, we have mapped out and elaborated the presence of the phenomenon of death as an idea, a theme, a figure, a sign, i.e. as a poetic and prosaic discourse on death; we have elaborated the presence of mimetic death, as an act and physical finality, and of symbolic death, in all its various figurative connotations of the topic, and in the respective form and literary genres.

In our path of trying to identify the idea and the concept of death, of differentiating between the representations of death from one work to another, of identifying similarities and differences, we came to conclusion that authors Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci and MitrushKuteli reveal different perspectives of the topic of death in their fictional texts. In these

divergences, based on the reading that has led us to intention of understanding *the narration and the figure – the metonymy and the metaphor* of death, the study concludes that the author conceive, create and promote plurality of discourses, highlighting the theme of death with which they reveal the philosophical power of the literary text.

In the reference texts, we have noted that they offer some of the most sensitive and most vulnerable scenes of death in all of Albanian literature - the death of Lokja, the death of Trina, the death of Nosit, the death of Gjeniu, the death of Tat Tanushi, the death of Xheladin Beu and the death of Ago Jakupi. These are protagonists who give their creators' *confession* of death, the inspiration, confrontation, reflection, thoughts and attitudes as well as the interpretation of the fundamental mystery of existence, in the point of view of Mjeda, Poradeci and Kuteli. Therefore, in the philosophy of the duality of human being life and death, each one of the authors approaches the subject of death in an entirely authentic way, in order to *illustrate* through words, in verse and in sentences, the absolute human phenomenon in its supremacy, and through the figuration of death and the philosophy on death, to create extraordinary literary acts and events related to death as well as profound contemplation on the finality and eternity of human beings.